



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2024

**VENDIM**  
**Nr. 156, datë 27.03.2024**

**PËR**  
**KOMANDIMIN E GJYQTARES {...} NË POZICIONIN E NËPUNËSIT**  
**PËRGJEGJËS PËR VLERËSIMIN, NË NJËSINË E VLERËSIMIT ETIK DHE**  
**PROFESIONAL TË GJYQTARËVE, NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54 pika 5 dhe 6 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 38, datë 31.01.2024 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

**VENDOSI:**

1. Komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
2. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon në datën 03.04.2024.
3. Përfundimin e menjëhershëm të gjyqtares {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**